



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Kuvendi i Kosovës
Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 8
Prishtinë, më 12. 06. 2008
Ndërtesa e Kuvendit, ora 10:00, salla N-225

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Sabri Hamiti, Xhavit Haliti, Ramë Buja, Eqrem Kryeziu, Lutfi Haziri, Ibrahim Gashi, Nexhat Daci, Ardian Gjini dhe Radmila Vujović.

Munguan: Enis Kervan dhe Ramadan Avdiu.

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Minire Hasani, Adelina Demolli dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Sabri Hamiti - kryetar i Komisionit, me këtë

RENDITE

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 09. 05. 2008 dhe 23. 05. 2008,
2. Rreth formimit të Grupit të Miqësisë ndërmjet Parlamentit të Republikës së Kosovës dhe të Parlamentit të Turqisë,
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 09. 05. 2008 dhe 23. 05. 2008

Procesverbalet e mbledhjeve të datave 09. 05 dhe 23. 05. 2008 u miratuan.

2. Rreth formimit të Grupit të Miqësisë ndërmjet Parlamentit të Republikës së Kosovës dhe Parlamentit të Turqisë

Sabri Hamiti - I njoftoi anëtarët e Komisionit se lidhur me këtë pikë është ftuar ministri Mahir Yagcilar, që është edhe nënshkrues i kërkesës për formimin e Grupit të Miqësisë të të dy parlamenteve.

Në Kryesinë e Kuvendit, është shqyrtuar kërkesa e nënshkruar nga M. Yagcilar, në të cilën është marrë qëndrim pozitiv për formimin e grupeve të miqësisë dhe është autorizuar Komisioni për Punë të Jashtme, që ta shqyrtojë dhe t'ia rekomandojë Kryesinë mënyrën e zgjedhjes së këtij grupi.

Ne do ta shqyrtojmë formimin e Grupit të Miqësisë ndërmjet Parlamentit tonë dhe Parlamentit të Turqisë dhe presim të formohen edhe grupet të tjera të miqësisë me parlamentet e vendeve të tjera.

Mahir Yagcilar - Tha se në cilësinë e deputetit e kam bërë një propozim, për krijimin e Grupit të Miqësisë ndërmjet Parlamentit të Kosovës dhe Parlamentit të Turqisë. Parlamenti i Turqisë në muajin mars e ka formuar Grupin e Miqësisë për Parlamentin e Kosovës, ku janë caktuar edhe anëtarët e Grupit. Grupi i Miqësisë i Parlamentit të Turqisë e ka një rregullore të punës, që në të ardhmen duhet ta bëjmë edhe ne, për bashkëpunim ndërmjet parlamenteve dhe për këmbim të përvojave. Në cilësi të deputetit tha se e ka marrë këtë iniciativë, ka biseduar me kryetarin e Grupit të Miqësisë në Turqi dhe është i gatshëm të vazhdojë të kontribuojë për krijimin e këtij grupi.

Në vazhdim tha se do të ishte mirë të formohej një grup prej 10 anëtarësh, në krye me kryetarin e këtij komisioni, me qëllim të krijimit të një afërsie më të madhe ndërmjet vendeve dhe për shfrytëzimin e përvojës së Turqisë.

Sabri Hamiti - Tha se në Kryesi ka pasur propozime që fillimisht të studiohet në grupe parlamentare, se cilët janë ata deputetë, që kanë njohuri, afinitet edhe vullnet të punojnë në një grup të tillë. Ka pasur edhe propozime që për formimin e Grupit të Miqësisë të shkohet me nga një përfaqësues të secilit grup parlamentar, të zgjedhur nga grupi parlamentar dhe nga sekretari i Kuvendit për përcjelljen e aktiviteteve.

Ardian Gjini - Tha se e përkrah propozimin për formimin e Grupit të Miqësisë dhe mendon se është një reagim yni pozitiv në këtë drejtim. Propozoi të caktohet për fillim nga një përfaqësues prej secilit grup parlamentar, me mundësinë që të mbetet grupi i hapur për ndonjë deputet që do të dëshironte të jetë i përfshirë në këtë grup në të ardhmen.

Nexhat Daci - Tha se e përkrah këtë ide, sepse kemi pas përkrahje të mirë të Turqisë dhe kemi nevojë për shumë arsye të jemi të pranishëm në Parlamentin e Turqisë. Objektivist një popullatë e madhe e këtyre trojeve shumë herët ka emigruar dhe është përshtatur në Turqi. Në fund shtoi se kjo praktikë duhet të vazhdojë edhe me shtetet e tjera dhe dalëngadalë të ndërtohen kapacitetet e një parlamenti demokratik.

Ramë Buja - Tha se kjo është një nismë e mirë dhe ka kuptim të dyfishtë. Krahas kuptimit politik, këtu kemi edhe arsye të tjera, siç tha z. Daci, sepse një numër shumë i madh i njerëzve tanë janë atje dhe një numër i komunitetit turk jeton këtu. Në vazhdim tha se e përkrah propozimin që ky Grup i Miqësisë të përbëhet nga një përfaqësues i grupeve parlamentare dhe të mbetet i hapur edhe për ndonjë deputet tjetër.

Ibrahim Gashi - Tha se e mbështet nismën, njëkohësisht edhe idenë që Grupi i Miqësisë ta ketë nga një përfaqësues prej secilit grup parlamentar. Propozoi që kjo praktikë të thellohet, duke vënë kontakte edhe me parlamentet e tjera. Lidhur me këtë Parlamenti i Suedisë do ta marrë një nismë të tillë dhe së shpejti do ta kemi propozimin.

Radmila Vujović - E përkrahu këtë nismë dhe e falënderoi ministrin M.Yagcilar për praninë që ta njoftojë Komisionin për këtë nismë.

Xhavit Haliti - Tha se do të ishte mirë të njoftohemi se çfarë fushash bashkëpunimi do të ofrojë ky grup dhe si do të ndërtohen këto raporte me Parlamentin e Turqisë, njëkohësisht edhe me parlamentet e tjera që do të pasojnë.

Sabri Hamiti - Tha se qëllimi i formimit të këtij grupi është krijimi i marrëdhënieve të një vendi me një vend tjetër në nivel parlamentesh.

Mahir Yagcilar - Tha se është i gatshëm për ndihmë në cilësi të deputetit për një periudhë të shkurtër, deri sa të formohet Grupi i Miqësisë të bisedohet me shefat e GP dhe të vihen kontaktet.

Komisioni pas diskutimeve e nxori këtë

P ë r f u n d i m

T'i rekomandohet Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës ta miratojë nismën për formimin e Grupit të Miqësisë ndërmjet Parlamentit të Republikës së Kosovës dhe Parlamentit të Turqisë.

Grupi i Miqësisë ndërmjet Parlamentit të Republikës së Kosovës dhe Parlamentit të Turqisë të përbëhet fillimisht me nga një përfaqësues prej secilit grup parlamentar dhe nga sekretari i Kuvendit me mundësi për plotësim varësisht nga interesat dhe aktivitetet që do të zhvillohen ndërmjet parlamenteve.

3. Të ndryshme

Ibrahim Gashi - Propozoi që në njërën nga mbledhjet e ardhshme të Komisionit të ftohet ministri i Punëve të Jashtme, që ta bëjë një paraqitje të aktiviteteve të tij që ka pasur gjer më tash dhe vizionin që e ka për ndërtimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Sabri Hamiti - Tha se e përkrah këtë propozim që njëkohësisht është detyrë e Qeverisë, edhe e Ministrisë.

Mbledhja përfundoi në orën 10:40 min.

Kryetari i Komisionit
Sabri Hamiti

Procesmbajtësi
Minire Hasani